

SOKOL GJERMËNI**AKTIVITETI I FEDERATËS “VATRA”
NË VITIN 1912***

Ndryshimet e reja që po ndodhnin në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare gjatë fundit të dekadës së parë dhe fillimit të dekadës së dytë të shek. XX gjetën jehonë të gjerë jo vetëm brenda vendit por edhe në kolonitë shqiptare të mërgimit. Diaspora shqiptare që jetonte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të përjetonte një evoluim ekzistencial, në zhvillimet e saj të brendshme në planin organizativ, drejtues, njerëzor, si edhe në planin e botimeve propaganduese. Ajo sikurse dhe simotrat e tjera të diasporës kombëtare u investua dhe veprroi në procesin e pasurimit, përhapjes dhe të nyjetimit të shqiptarisë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Qëllimi i saj ishte për t'iu bashkuar të njëjtit kohezion politik dhe diplomatik, i cili kërkonte jo vetëm kryengritje, por edhe pjesëmarrje, financime, kontribute, organizim dhe unitet për të ngarendur drejt Shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të shtetit të pavarur në Shqipëri. Shoqëritë dhe komitetet e kolonive shqiptare të mërgimit sidomos ato të Rumanisë dhe të Amerikës me propagandën e tyre kulturore, arsimore, politike si dhe me ndihmën direkte që i dhanë lëvizjes në Shqipëri u bënë vatra të rëndësishme të çështjes nacionale¹. Publikimi më 15 shkurt 1909 i numrit të parë të gazetës “Dielli” si pasuese e gazetës “Kombi”, me mbështetjen e Shoqërisë Besa-Besë, dhe mbërritja e Faik Konicës, i cili do të bëhej botuesi i gazetës “Dielli”, ishin momente historike që do të ndikonin në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare dhe politike të emigrantëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Shija e lirisë si dhe mjedisi i favorshëm për të zhvilluar e organizuar veprimtari patriotike dhe publicistike të pacensuruar nga shteti amerikan tërhoqën të tjerë nacionalistë shqiptarë në Amerikë.

* Kumesë e referuar në Konferencën Shkencore kushtuar 100-vjetorit të Federatës Panshqiptare “Vatra”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, mbajtur në Tiranë, 27 prill 2012.

¹ Zef Prela, “Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912)”, në: *Mbi Lëvizjen Kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 131-132.

Mbërritja e Kristo Floqit, për të zëvendësuar Faik Konicën si botues të “Diellit” më 1910, i dha impuls fushatës për të konsoliduar lëvizjen kombëtare të diasporës përmes bashkimit të shoqërive të ndryshme lokale që ishin krijuar në mes të emigrantëve shqiptarë. Emigracioni shqiptar ishte i fragmentarizuar në shumë shoqëri të ndryshme dhe integrimi i tij në një shoqëri të përgjithshme të kolonive shqiptare të Amerikës² ishte bërë një domosdoshmëri për çështjen e organizimit, të bashkërendimit dhe të drejtimit të lëvizjes shqiptare në këtë vend. Kërkesa e themelimit të një shoqërie të vetme patriotike tashmë kishte të bënte jo vetëm me faktin se duheshin mbajtur të gjalla traditat, gjuha dhe kultura kombëtare shqiptare në mesin e bashkësisë shqiptare të Amerikës, por edhe për faktin tjetër se bashkësia në fjalë ishte tashmë një nga mbështetjet kryesore të luftës dhe përpjekjeve në shkallë kombëtare për çlirimin nga sundimi osman dhe bashkimin e viseve shqiptare në një shtet të veçantë³.

Në mbledhjen e 31 marsit 1912, diskutimet e patriotëve u përqendruan rreth platformës dhe kanunores që do të kishte federata e tyre e re. Në një takim tjetër të datës 9 prill 1912 u miratua përmbajtja nen për nen, si dhe u diskutua për kohën, vendndodhjen dhe qëllimet e federatës⁴. Këto përpjekje përfunduan me krijimin në Boston në prill 1912 të Federatës Panshqiptare të Amerikës “Vatra”, me organ zyrtar “Diellin” dhe Faik Konicën si Sekretarin e përgjithshëm të parë të saj⁵. Më 28 prill 1912, kjo federatë e kolonisë shqiptare u njoh zyrtarisht nga ana e qeverisë amerikane. Me anë të këtij njoftimi u njoh edhe kombësia shqiptare në Amerikë, sepse s’duhet harruar se shqiptarët kur vinin në Amerikë, në Castel Garden njiheshin si “rum” (grekë) ose si “turq” (turk)

² Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: ShBLU, 2008, f. 60-70. Në këtë kohë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekzistonin shumë shoqëri të ndryshme me karakter politik dhe kulturor-arsimor, ku shqiptarët ishin të organizuar. Disa prej këtyre shoqërive ishin: “Besa-Besë”, “Flamuri i Krujës”, “Arsimi”, “Mall’i Mëmëdheut”, “Dallëndyshja”, “Përlindja”, “Lidhja”, “Skënderbeu”, “Shoqëria Kombëtare”, “Yll’ Afërdita”, “Bashkimi”, “Përparimi”, “Shqypnia”.

³ Valentina Duka, *Shqiptarët në rrjedhat e shekullit XX*, Tiranë: Panteon&Afërdita, 2001, f. 69.

⁴ *Po aty*, f. 82.

⁵ Stephen Peters, “Charateristics, contributions and responsibilities of Albanain-Americans”, në: *Seminari Ndërkombëtar i Federatës “Vatra”*, botues Hamdi H. Oruçi, Roma, 1971, f. 90-91.

e kurrë një herë si shqiptarë⁶. Më 28 prill u emërua përkohësisht pleqësia si dhe zyrtarët e Federatës. Kristo Floqi dhe Faik Konica u zgjodhën prej mbledhjes si organizatorë të degëve federale, ndërsa at Fan Noli mori përsipër të organizonte tri degët më të afërme për t'i ardhur në ndihmë të parëve, të cilët kishin shumë degë për të organizuar. Më 12 maj 1912 në Washington Hall u formua panegjirikisht dega e parë federale e Bostonit nën kryesinë e Fan Nolit⁷. Për të konkretizuar më mirë funksionimin e Federatës Panshqiptare “Vatra”, tre figurat kryesore të saj, Fan Noli, Faik Konica dhe Kristo Floqi brenda një kohe të shkurtër, u shpërndanë nëpër qendra të ndryshme urbane amerikane për të formuar degët e shoqërisë të sapothemeluar⁸.

Në prag të fillimit të Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912 shtypi shqiptar këmbëngulte fort në realizimin e kërkesave të vitit 1911. Arsyeja ishte sepse këto kërkesa pasqyronin objektivat themelore të mbarë shqiptarëve. Kjo vendosmëri ishte aq e madhe saqë “tundi edhe mendimin popullor në botë dhe u shfaq që ka një Shqipëri të pjekur për liri e bashkim kombëtar”⁹. Në vigjilje të saj mendimi që shfaqej ishte ai për realizimin e një autonomie administrative dhe ky ishte gjithashtu dhe mendimi i kryengritësve. Kjo pikëpamje ishte pranuar dhe propagandohej edhe nga shoqëritë patriotike shqiptare brenda dhe jashtë vendit. Federata “Vatra” e trajtoi këtë qëndrim me anë të shkrimeve të autorëve të saj në organin e shtypit gazetës “Dielli”¹⁰.

Patriotët vatran duke e ditur kompleksitetin, shpejtësinë me të cilën po ndodhnin ngjarjet, vështirësitë në të cilën gjendeshin bashkëkombasit brenda Perandorisë Osmane dhe paqartësinë se çfarë do të bëhej me ta të nesërmen u angazhuan nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së alternativave të mendimit politik. Vëmendja u përqendrua në çështje të tilla se çfarë duhej të bënte, çfarë të kërkonte dhe ç’qëndrim do të mbante lëvizja kombëtare në këto rrethana përballë Stambollit. Në bazë të informacioneve që merrnin rreth zhvillimeve në viset shqiptare dhe

⁶ Atlanticus, “Federata Panshqiptare “Vatra”, në: *Agimi*, Nr. II, vjeti I, Shkodër, Marc 1920, f. 172.

⁷ *Po aty*.

⁸ V. Duka, *Shqiptarët në rrjedhat ...*, f. 84.

⁹ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-IV-412, Zihni Haskaj, “Problemi i autonomisë së Shqipërisë gjatë kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 sipas shtypit të kohës”, Tiranë, 1985, f. 78.

¹⁰ *Po aty*, f. 86-88.

perceptimeve personale ata u përpoqën të projektonin perspektivën e afërt dhe të largët të *status quo-së* në të cilën ishte dhe do të gjendej Shqipëria. Një ndër autorshkruesit ishte Faik Konica. Ai theksonte se “shqiptarët s’duhet të gënjejnë si në lëvizjen xhonturke, premtimeve të së cilës u besuan dhe pastaj pësuan dhunën dhe terrorin xhonturk. Le të kuptojmë mirë për të fituar të drejtat tona”¹¹. Një aspekt i rëndësishëm i lëvizjes kombëtare ku duhej të punonte fort ishte kundërvënja ndaj ideologjisë dhe politikës xhonturke. Kjo e fundit synonte që me lëshime të herëpashershme të ndalonte shqiptarizmin dhe të neutralizonte revolucionin kombëtar, kulturor dhe politik të shqiptarëve, i cili kishte si qëllim shkëputjen nga Perandoria Osmane.

Në këtë drejtim “Vatra” veproi me synimin që të frymëzonte si udhëheqësit ashtu dhe lëvizjen kryengritëse që të mos binin pre e premtimeve të politikës së osmanëve. Kjo çështje gjeti pasqyrim dhe në artikullin e gazetës “Dielli” me titull “Kryengritja dhe detyrat e shqiptarëve” të datës 16 maj 1912 ku theksohej se “shqiptarët u ngopnë nga xhonturqit edhe më fort nga reformat me të cilat as ndreqet dot Shqipëria, as turqit s’e mballosnin dot, sikur edhe të deshnin me të vërtetë”¹². Në mbledhjen që mbajtën krerët e kryengritjes në Junik më 21-25 maj 1912 u formuluan kërkesat e Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare, të cilat iu drejtuan Perandorisë Osmane. Nevojës për njohje, shpallje dhe komunikim të kërkesave kombëtare që miratoi ky kuvend i shërbyen dy gazetat e diasporës “Dielli” dhe “Liri e Shqipërisë”. Ato i botuan vendimet e Junikut duke ia bërë të njohura popullit shqiptar dhe opinionit publik botëror¹³. Më 13 qershor 1912, Federata Panshqiptare “Vatra” u njoh zyrtarisht dhe mori diplomën e saj* të nënshkruar prej Albert Lengtit (Albert Langty), sekretar i Shtetit të Masaçusets¹⁴. Gjatë verës së vitit 1912 “Vatra” organizoi fushatën për të përkrahur kryengritjen. Ajo mbajti një miting të madh, i cili u zhvillua me parullën e autonomisë administrative të Shqipërisë nën Perandorinë Osmane, si dhe mbledhjen e ndihmave financiare. Por, formalisht zyrtarët e

¹¹ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 36.

¹² *AIH*, A-IV-412, Z. Haskaj, “Problemi i autonomisë...”, f. 101.

¹³ Niko Koleci, “Kryengritja e përgjithshme shqiptare”, në: *Mbi Lëvizjen...*, f. 46.

* Emrat e shqiptarëve që e nënshkruan deklaratën e njohjes dhe që gjenden të shkruar në diplomë janë: Faik Konica, Llambi Çikozi, Fan Noli, Kristo Floqi, Elia Tromara, Naum Cera dhe Kosta Kota.

¹⁴ V. Duka, *Shqiptarët në rrjedhat ...*, f. 85.

Federatës u përpoqën që të mos e ekspozonin shoqërinë e tyre, pasi ajo ishte njohur nga shteti si një shoqëri kulturore që s' duhej të përzihej në politikë¹⁵. Në këtë kohë në Shqipëri po diskutohej ideja e mbajtjes së një kuvendi kombëtar.

Mendimi për thirrjen e një kuvendi të përgjithshëm në Shqipëri tërhoqi vëmendjen e Federatës “Vatra”, e cila mori pjesë në diskutimet që kishin të bënin me këtë çështje. Disa ditë para se të binte qeveria xhonturke, kishte veprimtarë të lëvizjes kombëtare, të cilët shtronin nevojën “për të biseduar një plan për çështjen shqiptare”. Ata mendonin që të bëheshin dy mbledhje një në Cetinë për shqiptarët e Veriut dhe një në Korfuz për ata të Jugut. Qëndrimi i “Vatrës” ishte i ndryshëm. Ajo ishte për organizimin e një mbledhjeje të përbashkët për të gjithë shqiptarët, e cila të mbahej “brenda në Shqipëri”¹⁶. Mendimi politik i udhëheqësve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara nuk ndryshonte prej atij të krerëve nacionalistë në Shqipëri¹⁷. Opinioni i shprehur në faqet e gazetës “Dielli” se po të nxirrej Turqia jashtë Europës, Shqipëria duhej të bëhej një shtet i pavarur dhe të drejtohej nga një princ evropian, ishte dhe mendimi i shumicës së krerëve shqiptarë¹⁸. Me fillimin e vjeshtës, “Vatra” e vuri theksin, gjithnjë e më shumë, te rreziku që paraqisnin fqinjët ballkanikë për Shqipërinë. Udhëheqësit e saj bazoheshin te reagimi negativ që kishin shfaqur shtetet ballkanike ndaj atyre pak lëshimeve që Stambolli u detyrua t’u bënte shqiptarëve. Gjithashtu, ata paralajmëronin se tani e tutje synimet aneksioniste të fqinjëve do të përbënin rrezikun kryesor për Shqipërinë. Gazeta “Dielli” shkruante se “Posa u mat Turqia sikur të na jap një hije autonomie menjëherë fqinjët tanë filluan të lehin dhe të bëhen gati të na sulen. Sjellja e fqinjëve tanë tani që Turqia është në këmbë, na tregon sjelljen e tyre në qoftë se ajo përmbysset”¹⁹. Diaspora shqiptare në Amerikë duhej të tregohej e kujdesshme edhe për vështirësitë që ajo haste në tokën e lirisë. Një prej tyre ishte përballja me nacionalizmin dhe aktivitetin e emigracionit grek, i cili luftonte jo vetëm ndaj aktivitetit të “Vatrës”, por sidomos ndaj anëtarësimit dhe militimit të shqiptarëve ortodoksë në këtë organizëm.

¹⁵ B. Meta, *Federata Panshqiptare ...*, f. 38.

¹⁶ AIH, A-IV-412, Z. Haskaj, “Problemi i autonomisë së ...”, f. 176.

¹⁷ Stavro Skëndi, *Mendimi politik dhe veprimtaria kryengritëse shqiptare (1881-1912)*, New York, 1958, f. 29.

¹⁸ *Po aty*, f. 36.

¹⁹ B. Meta, *Federata Panshqiptare ...*, f. 38-39.

Pjesëmarrja masive e shqiptarëve të Toskërisë në Federatën “Vatra” shkaktoi një mobilizim më të madh të nacionalizmit dhe propagandës që zhvillonte diaspora greke në Amerikë për shkak të interesave aneksioniste që shteti grek kishte në drejtim të Shqipërisë së Jugut. Bashkimi Panepirotik i Amerikës ishte hapi i parë për t’ju kundërvënë veprimtarisë patriotike që po shfaqte diaspora shqiptare. Goditja u bë në dy plane. Në planin e brendshëm objektivi ishte, që të minimizohej dhe të minohej efektiviteti i veprimtarisë së “Vatrës” për zgjimin e ndjenjave kombëtare të emigrantëve shqiptarë, me qëllim që propagandës “vorioepiriotë” t’i krijohej fushë e lirë. Në planin ndërkombëtar synimi ishte, që të mos dilte një organizatë përfaqësuese e emigracionit shqiptar në Amerikë, pasi ajo do t’i krijonte mjaft vështirësi politikës greke. Që në vjeshtën e vitit 1912, Federatës “Vatra” iu desh të përpiqej shumë për të kundërshtuar një fushatë të organizuar nga konsujt grekë në SHBA për “mbledhjen e ndihmave” prej emigrantëve shqiptarë në favor të ushtrive greke, të cilat luftonin gjoja për “të shpëtuar” Shqipërinë nga thonjtë e Turqisë²⁰.

Në prag të fillimit të Luftës Ballkanike përpara Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ekzistonin shtigje shumë të ngushta manovrimi, kjo për arsye të rrethanave politike të krijuara, por, në radhë të parë, për shkak të synimeve të qarta të fqinjëve ballkanikë për të aneksuar territoret shqiptare. Sidoqoftë, teorikisht ekzistonin tre mundësi: a) përfshirja e Shqipërisë në Aleancën Ballkanike dhe luftë e përbashkët kundër pushtuesve osmanë; b) një aleancë me Turqinë, duke mbështetur ushtrinë osmane në luftë kundër aleatëve ballkanikë dhe c) qëndrimi asnjës në konfliktin ballkanik. Ashtu si në rrethet e tjera të Lëvizjes Kombëtare këto alternativa u diskutuan dhe u analizuan edhe në shoqëritë patriotike të diasporës shqiptare në Amerikë dhe konkretisht nga Federata “Vatra”. Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike krijoi një periudhë të ndërlikuar dhe kontradiktore për Shqipërinë. Për rrethet atdhetare çështja më e rëndësishme historike për kohën ishte shpëtimi i viseve shqiptare nga katastrofa eventuale e Perandorisë së Gjysmëhënës dhe nga rreziku i copëtimit, për shkak se nëse ngjarjet do të krijonin këtë realitet, pasoja e tij do të ishte likuidimi i Shqipërisë nga harta politike e Ballkanit. Cili ishte qëndrimi i qarqeve patriotike shqiptare të “Vatrës” në Amerikë? Më 7 tetor 1912, Federata “Vatra” organizoi një mbledhje të madhe në

²⁰ *Po aty*, f. 58-59.

Boston, ku përfaqësues nga i gjithë New Englandi dëgjuan të habitur kërkesën e krerëve të tyre për të mbështetur Perandorinë Osmane. Pas mbledhjes, drejtuesi i saj, hirësia e tij prifti Naum Cere, tha: “Turqia, duke ua pranuar kryengritësve shqiptarë kërkesat e tyre e bëri të mundshme ekzistencën e Shqipërisë. Ky zhvillim që një goditje vdekjeprurëse për ambiciet cenonjëse të shteteve ballkanike. Prandaj duket sheshit që interesi ynë qëndron në një bashkëpunim të përzemërt me ushtrinë osmane kundër armiqve të Perandorisë, që janë kryesisht armiq të Shqipërisë”²¹.

Ky qëndrim i kolonive shqiptare të SHBA-së nisej nga fakti se ajo që përbënte në ato çaste të keqen më të madhe për shqiptarët nuk ishte Porta e Lartë, e cila sidoqoftë u kishte njohur atyre disa të drejta kombëtare, por shtetet e aleancës ballkanike, të cilat synonin ta fshihnin nga faqja e dheut emrin e Shqipërisë²². Kur shpërtheu Lufta e Parë Ballkanike udhëheqësit nacionalistë kërkuan menjëherë “pamvarësinë e Shqipërisë”. Mendojmë se ky qëndrim mund të jetë influencuar nga perceptimi dhe bindja personale e dy prej drejtuesve kryesor të diasporës shqiptare në Amerikë, Nolit dhe Konicës. Të dy këta udhëheqës të shqiptarëve besonin dhe thoshin se Turqia nuk do ta humbiste kurrë luftën dhe nuk donin të besonin se simpatia e Austro-Hungarisë për Shqipërinë do të kthehej në veprim politik²³. Ndonëse frymëzohej nga qëllime patriotike, ky qëndrim përmbante në vetvete një rrezik të madh për vendin. Përkrahja pa kushte që shqiptarët do t’i jepnin Perandorisë Osmane në luftë kundër Aleancës Ballkanike do të sillte si pasojë që Shqipëria të pësonte të njëjtin fat që do të pësonte Porta e Lartë në Ballkan. Në këtë mënyrë qeveritë e Aleancës Ballkanike do të kishin një argument të fortë për të mbrojtur përpara diplomacisë së Fuqive të Mëdha planin e copëtimit të Shqipërisë duke e konsideruar atë një provincë e thjeshtë turke²⁴.

Pavarësisht arsytimit pragmatik dhe argumenteve të sjella se ky mund të ishte një pozicionim në favor të Shqipërisë historia i kundërshtoi idetë e tyre. Ky qëndrim i gabuar që u shfaq nga “Vatra” do të ndryshonte më vonë kur atë do ta zhvleftësonte koha²⁵. Ndryshimet që po sillte Lufta

²¹ Stavro Skëndi, *Zgjidhja Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: Phoenix&ShLK, 2000, f. 408.

²² Stefanaq Pollo, *Në gjurmë të historisë shqiptare I*, Tiranë: 8 Nëntori, 1990, f. 302.

²³ S. Skëndi, *Mendimi politik ...*, f. 36.

²⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II (Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX – 1912), Tiranë: Toena, 2002, f. 504.

²⁵ B. Meta, *Federata Panshqiptare ...*, f. 40-41.

e Parë Ballkanike rreth situatës dhe të ardhmes së mëmëdheut i motivuan dhe i udhëhoqën patriotët vatran për ta vlerësuar më mirë koniunkturën ballkanike dhe fatin e bashkatdhetarëve të tyre. Aq më shumë kur rreziku i shpërbërjes së vendit tanimë gjithmonë e më tepër ishte një realitet sesa mundësi. Konica ishte një nga personalitetet e para të Federatës, i cili do të reflektonte dhe personalisht, lidhur me gjendjen që po krijohet për Shqipërinë. Kolonia e shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara nuk mbeti prapa në përpjekjet e saj për të penguar copëtimin e Shqipërisë. Më 17 nëntor 1912, “Vatra” organizoi një mbledhje masive në Boston, ku orator kryesor ishte Faik Konica. Ai e njohu disfatën e Turqisë duke u shprehur se: “Turqia u mund dhe Shqipëria është shkelur dhe në rrezik të copëtohet. Ç’duhet të bëjmë ne shqiptarët nacionalistë për të shpëtuar atdheun tonë?”. Reagimet e para ishin të natyrës diplomatike duke u përpjekur që të përfaqësonin sa më mirë dhe sa më shumë të drejtat e shqiptarëve në këtë realitet të ri, jo vetëm brenda Gadishullit të Ballkanit, por edhe jashtë tij. U shkruan rezoluta duke vënë në dispozicion mundësitë financiare të “Vatrës” për të shpëtuar Shqipërinë. Kablllograme iu dërguan perandorëve të Austrisë, të Gjermanisë, mbretit të Italisë, Papës, ministrive të Jashtme të Rusisë e Francës si edhe presidentit amerikan Taft. Këtyre shteteve iu kërkohet që të parandalohej copëtimi i Shqipërisë, pasi nëse ndodhte kjo, atëherë në Ballkan do të kishte kryengritje të mëdha²⁶. Federata “Vatra” ka mbajtur një qëndrim të ashpër dhe kritik ndaj qeverisë së Vlorës. Ky qëndrim buronte kryesisht nga dëshirat e zjarra të patriotëve shqiptarë për ta parë Shqipërinë me një vetëqeverim të sigurt, me një shtet modern dhe të fuqishëm. Sidoqoftë predispozicioni i “Vatrës” ishte që të përkrahte me sa mundej qeverinë e parë kombëtare²⁷.

Aktin e shpalljes së Pavarësisë, “Vatra” e përshëndeti për zemërsisht me anë të një telegrami urimi. Një shqetësim për Federatën Panshqiptare, ishte çështja e orientimit dhe e ardhmja e Shqipërisë. Për këtë arsye, Faik Konica, botoi në gazetën “Dielli” katër argumentet se pse në krye të fronit mbretëror të Shqipërisë nuk duhej të ulej një princ mysliman. Sipas tij, paqja dhe siguria në Shqipëri mund të ndërtohen vetëm nëpërmjet një

²⁶ S. Skëndi, *Zgjimi Kombëtar...*, f. 412; Më shumë shih: Refat. Xh. Gurrazezi, *Historia e Federatës “VATRA”*, Tiranë: Globus R, 2006, f. 41-42; V. Duka, *Çështje të historisë...*, f. 81.

²⁷ B. Meta, *Federata Panshqiptare...*, f. 77.

dinastie oksidentale²⁸. Gjatë kësaj kohe vëmendja e federatës u përqendrua rreth faktit sesi mund ta ndihmonte ajo shtetin e sapolindur. Në kuvendin e jashtëzakonshëm, i cili u mbajt më 8 dhjetor 1912 u vendos njëzëri që Faik Konica të dërgohej si delegat i diasporës shqiptare të Amerikës, në Europë dhe në Shqipëri për të marrë pjesë në diskutimin e problemeve të rëndësishme për të ardhmen e popullit shqiptar²⁹. Për këtë arsye, ai u ngarkua të parashtronte “përpara mbledhjes së kombit dhe njerëzve politikë ca mendime për të zgjedhurit e një dere mbretërore për fronin e Shqipërisë dhe për të themeluarit të konstitucjes”, të parashtronte platformën politike të “Vatrës”, për zhvillimet e mëtejshme politike në Shqipëri. Por, Faik Konica nuk e kreu si duhet këtë detyrë. Për rrjedhojë nuk u realizua ai bashkëpunim i dëshiruar midis emigracionit shqiptar në Amerikë dhe qeverisë së Vlorës, çka ishte i mundur dhe i domosdoshëm për interesat e kombit. Një ofertë për të bashkëpunuar me qeverinë e përkohshme ia bëri dhe Noli, Ismail Qemalit, por ajo mbeti pa përgjigje³⁰. Federata e shqiptarëve në Amerikë e perceptoi fatin e Shqipërisë përballë vendimeve që do të merrte Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, duke u frymëzuar nga parimet e lirisë dhe të drejtës së një kombi për të jetuar i pavarur në shtetin që ai vet dëshiron të ketë. Në lidhje me diplomacinë ndërkombëtare, udhëheqësit vëtruan shpresonin se Evropa do t’i njihte kufijtë e Shqipërisë duke pasur parasysh kriterin etnik dhe të drejtën historike të kombit shqiptar. Sipas tyre interesi gjeopolitik ishte ai që duhej marrë në konsideratë. Gazeta “Dielli” shtronte pyetjen se në qoftë se asaj “do t’i rrëmbejnë vendet më të pasura ku do t’i gjejë të hollat e nevojshme që të vetëqeveriset siç duhet, të ketë një administratë serioze dhe një ushtri për të qenë?”³¹.

Edhe pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, drejtuesit e federatës mendonin se duhej shfrytëzuar, sa të ishte e mundur, konflikti turko-ballkanik, gjithnjë duke mbështetur Portën e Lartë me qëllim që në konferencën që po zhvillohej në Londër për Ballkanin, Perandoria Osmane të mbronte tërësinë tokësore të Shqipërisë. Sipas tyre duhej të bëheshin përpjekje për të ndikuar që ajo të mos ua jepte Shqipërinë aleatëve ballkanikë si këmbim të paqes me ta, transaksion ky që mund t’i interesonte shumë Stambollit. Faik Konica vazhdonte të shpresonte se

²⁸ Për më shumë shih: V. Duka, *Çështje të historisë...*, f. 82-83.

²⁹ V. Duka, *Shqiptarët në rrjedhat...*, f. 88.

³⁰ B. Meta, *Federata Panshqiptare ...*, f. 77-78.

³¹ *Po aty*, f. 64.

qëndrimi i përfaqësuesve të delegacionit osman në Konferencën e Londrës do ishte në favor të Shqipërisë. Ai pohonte se delegacioni osman në Konferencën e Londrës ishte gati të njihte autonominë e Shqipërisë. Ky qëndrim i Konicës ishte i gabuar, vetë “Vatra” e ndryshoi atë 2-3 muaj më vonë. Që në atë kohë pati reagime lidhur me këtë qëndrim të “Vatrës” dhe të gazetës “Dielli”. Më ashpër reagoi gazeta “*Liri e Shqipërisë*”, e cila i kritikonte shqiptarët e Amerikës për qëndrimin proosman. Në polemikën e tij me gazetën “Liri e Shqipërisë”, duke mbrojtur pozicionin e udhëheqësve të Vatrës, organi i saj “Dielli”, shkruante se: “*në qoftë se turqit na kishin futur një pash nën dhe, sllavo-grekët do të na fusin dhjetëra metra më thellë*”. Ndër të tjera, përmendej qëndrimi i pabesë i shteteve fqinje ndaj shqiptarëve gjatë kryengritjeve kundërosmane, të cilët kur panë fuqizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u trembën prej saj dhe kërkuan luftën “duke vënë përpara kryqin që të shpëtonin krishterimin”. Nga ana e saj, “Vatra” kundërshtonte pikëpamjen e gazetës “Liri e Shqipërisë”, mbi një aleancë të shqiptarëve me fuqitë ballkanike kundër Portës së Lartë. Ajo e cilësonte këtë si vetëvrasje, pasi do t’u jepte dorë sllavo-grekëve të copëtonin Shqipërinë. Për të argumentuar këtë rrezik “Dielli” sillte shembullin e kryengritjes së Malësisë së Madhe. Kur malësorët, në aleancë me knjazin e Malit të Zi, sulmuan turqit rezultati ishte i hidhur për ta, pasi Cetina u përpoq që ta shfrytëzonte këtë kryengritje për t’i marrë Shqipërisë disa territore. Ndonëse nuk ishin në dijeni të marrëveshjeve të fshehta të shteteve ballkanike në kurriz të Shqipërisë, udhëheqësit e “Vatrës”, duke u bazuar në përvojën e hidhur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, nga Lidhja e Prizrenit e deri në këtë kohë, arrinin në përfundimin se aderimi në Aleancën Ballkanike ishte i pamundur, madje shumë i rrezikshëm. Në atë kohë kjo pikëpamje ishte e përhapur edhe në rrethe të tjera të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Depërtimi i ushtrive pushtuese të shteteve ballkanike në territorin shqiptar dhe disfatat e rënda të ushtrisë osmane bënë të pavlefshme si aleancën me Turqinë, ashtu edhe qëndrimin asnjans në konfliktin ballkanik³². Për hir të autonomisë së Shqipërisë ata propozonin që t’i jepnin fjalën dhe çdo ndihmë ushtarake Turqisë.

Si përfundim mund të themi se Federata Panshqiptare “Vatra” me veprimtarinë e saj që u manifestua gjatë vitit 1912, luajti një rol të

³² B. Meta, *Federata Panshqiptare ...*, f. 44-46.

rëndësishëm në kërkimin, prezantimin, mbrojtjen dhe përkrahjen e çështjeve të ndryshme për të drejtat e shqiptarëve. Elita e saj iu përgjigj ndjeshmërisht kërkesave që ishin të rëndësishme për Shqipërinë, duke lobuar me frymë patriotike që të përmbushte ëndrrën e jetësimit të ekzistencës së një kombi dhe të një shteti modern të pavarur. Me aktivitetin e saj gjatë vitit 1912, kjo organizatë u përpoq që të realizonte të gjitha objektivat për të cilat ajo u krijua dhe nevojave që Shqipëria kishte dhe priste të përmbusheshin prej diasporës shqiptare në Amerikë të udhëhequr nga Federata Panshqiptare “Vatra”.

Kjo federatë dha një ndihmesë të pallogaritshme për mërgimtarët shqiptarë kudo në Amerikë, duke i informuar për gjendjen e trazuar në Shqipëri, duke ndihmuar në ruajtjen e trashëgimisë së tyre etnike si edhe në koordinimin e veprimeve të tyre në përkrahje të mëmëdheut³³. Ajo arriti të realizojë procesin e integritit dhe të institucionalizojë aktivitetin e diasporës shqiptare nëpërmjet një qendre të vetme, me qëllim koordinimin e çdo nisme si një organizim unik për të përfaqësuar kombëtarisht të gjithë diasporën dhe për t’i ndihur qëllimeve dhe aspiratave të kombit jo vetëm në Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëri, por edhe më gjerë. “Vatra” ia doli të krijojë një ligjërim të fuqishëm dhe të zjarrtë me një zë për mbrojtjen e të drejtave të bashkatdhetarëve, duke i frymëzuar dhe motivuar njerëzit për ta përdorur ëndrrën e lirisë jo vetëm në shërbim të vetes së tyre por edhe të kombit të cilit i përkisnin.

³³ Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Kartë e Pendë dhe Fondacioni Abraham Linkolin, Tiranë: 2004, f. 339.

